

20101563294

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Në përputhje me nenin 77 paragrafi 1 të ligjit “Për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 7/05, 47/06, 42/07, 86/08 dhe 72/100) Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

RREGULLOREN PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR FORMULARËT E ARMËVE DHE MUNICIONEVE DHE PËR MENAXHIMIN E MBAJTJES SË REGJISTRAVE TË ARMËVE DHE MUNICIONEVE

Neni 1

Në Rregulloren për formularët e armëve dhe municioneve dhe për menaxhimin e mbajtjes së regjistrave të armëve dhe municioneve (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 94/09 dhe 2/10) pas fjalëve: “certifikatë për posedimin e armës” në nenin 1, shtohen fjalët e mëposhtme: “certifikatë për posedimin e armës që zëvendëson autorizimin për posedimin e armës; certifikatë për posedimin e armës së bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar),” dhe pas fjalëve: “e papërdorshme në mënyrë të përhershme”, fjalët: “certifikatë për posedimin e armëve të zjarrit të bëra përkohësisht të papërdorshme (të çaktivizuara)”.

Neni 2

Pas nenit 12, shtohen dy nene të reja, neni 12-a dhe neni 12-b, me tekstin e mëposhtëm:

“Neni 12-a

Formulari i certifikatës për posedimin e armës që zëvendëson autorizimin për posedimin e armës hartohet në letër të bardhë me përmasa 21 x 30 cm.

Certifikata e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban të dhënat e mëposhtme: mbajtësin e autorizimit për posedimin e armës; numrin e regjistrimit të autorizimit që zëvendësohet; autoritetin lëshues të autorizimit që zëvendësohet; armën që posedohet (kategoria, lloji, marka, kalibri dhe numri i serisë); si edhe hapësirën për vulën dhe nënshkrimin e personit të autorizuar në autoritetin kompetent.

Seksioni i poshtëm i certifikatës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban tekstin e mëposhtëm:

“SHËNIM: Kjo certifikatë nuk e autorizon zotëruesin të përdorë armën” (Formulari nr. 17-a).

Neni 12-b

Formulari i certifikatës për posedimin e armës që është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar) hartohet në letër të bardhë me përmasa 21 x 30 cm

Certifikata e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban të dhënat e mëposhtme: zotëruesin e armës që është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar) (person fizik ose juridik); shoqërinë që ka kryer procedurën teknike për bërjen e armës përkohësisht të papërdorshme (çaktivizimi); procedurën teknike përmes së cilës arma është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar); armën që është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar) (kategoria, lloji, kalibri dhe numri i serisë); dokumentin e armës (numri i regjistrimit, data e lëshimit dhe emërtimi i dokumentit të armës); nënshkrimin e personit të autorizuar në komisionin e autoritetit kompetent për lëshimin e certifikatës për posedimin e armës që është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar) dhe vula e autoritetit kompetent për lëshimin e certifikatës për posedimin e armës që është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar) (Formulari nr. 17-b).

Neni 3

Pas nenit 14, shtohet neni i ri 14-a me tekstin e mëposhtëm:

“Neni 14-a

Formulari i certifikatës për posedimin e armëve të zjarrit të bëra përkohësisht të papërdorshme (të çaktivizuara) hartohet në letër të bardhë me përmasa 21 x 30 cm.

Certifikata e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban të dhënat e mëposhtme: zotëruesin e armës së bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar) (person fizik); vendimin për trashëgiminë; shoqërinë që ka kryer procedurën teknike për bërjen e armës përkohësisht të papërdorshme (çaktivizimi); procedurën teknike përmes së cilës arma është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar); armën që është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar) (kategoria, lloji, kalibri dhe numri i serisë); dokumentin e armës (numri i regjistrimit, data e lëshimit dhe emërtimi i dokumentit të armës); nënshkrimin e personit të autorizuar dhe vulën e autoritetit kompetent për lëshimin e certifikatës për posedimin e armës që është bërë përkohësisht e papërdorshme e (çaktivizuar).

Seksioni i poshtëm i certifikatës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban tekstin e mëposhtëm:

“SHËNIM: Kjo certifikatë nuk e autorizon zotëruesin të përdorë armën” (Formulari nr. 19-a).

Neni 4

Në nenin 25 paragrafi 1, pas numrit 7 shtohen dy numra të rinj 8 dhe 9 me tekstin e mëposhtëm:

“8. Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armëve që zëvendësojnë autorizimet për posedimin e armëve;

9. Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armëve të bëra përkohësisht të papërdorshme (të çaktivizuara);”

Numrat 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 bëhen numrat 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16. Pas numrit 12, i cili u bë numri 17, shtohet një numër i ri 18 me

tekstin e mëposhtëm:

“18. Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armëve të zjarrit të bëra përkohësisht të papërdorshme (të çaktivizuara);”

Numrat 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21 bëhen numrat 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24.

Neni 5

Pas nenit 32, shtohen dy nene të reja, neni 32-a dhe neni 32-b, me tekstin e mëposhtëm:

“Neni 32-a

Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armëve që zëvendësojnë autorizimet për posedimin e armëve, përbëhet nga kolonat vijuese: numri rendor, numri i regjistrimit të certifikatës, data e certifikatës, personi fizik, arma dhe shënime (Formulari nr.45-a).

Në formularin e regjistrimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni vendosen të dhënat e mëposhtme: në kolonën “Numri rendor”, vendoset numri rendor i hyrjes; në kolonën

“Numri i regjistrimit të certifikatës”, vendoset numri i regjistrimit të certifikatës për posedimin e armës që zëvendëson autorizimin për posedimin e armës; në kolonën “Data e certifikatës”, vendoset data e lëshimit të certifikatës për posedimin e armës që zëvendëson autorizimin për posedimin e armës; në kolonën “Personi fizik”, vendoset emri, mbiemri, adresa e vendbanimit të përhershëm ose të zakonshëm dhe numri personal i identifikimit të personit fizik; në kolonën

“Arma”, vendoset kategoria, lloji, marka, kalibri dhe numri i serisë së armës; dhe në kolonën “Shënim”, vendoset çdo ndryshim thelbësor në të dhënat e vendosura më parë në regjister.

Neni 32-b

Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armës së bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar) përbëhet nga kolonat e mëposhtme: numri rendor; personi fizik ose juridik; shoqëria; numri i regjistrimit dhe data e miratimit për prodhimin e armëve dhe municioneve dhe për riparimin e armëve; procedura teknike; dokumenti i armës; dhe shënime (Formulari nr. 45-b). Në formularin e regjistrimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni vendosen të dhënat e mëposhtme: në kolonën “Numri rendor”, vendoset numri rendor i hyrjes; në kolonën “Personi fizik ose juridik”, vendoset emri, mbiemri, adresa e vendbanimit të përhershëm ose të zakonshëm dhe numri personal i identifikimit i personit fizik ose emri, selia dhe numri tatimor i personit juridik që zotëron armën që është bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar); në kolonën “Arma”, vendoset kategoria, lloji, marka, kalibri dhe numri i serisë së armës së bërë përkohësisht e papërdorshme (e çaktivizuar); në kolonën “Shoqëria”, vendoset emri, selia, numri tatimor dhe kodi i veprimtarisë së biznesit të shoqërisë që ka kryer procedurën teknike të bërjes së armës përkohësisht të papërdorshme (çaktivizimi); në kolonën “Numri i regjistrimit dhe data e lëshimit të miratimit për prodhimin e armëve dhe municioneve dhe për riparimin e armëve” vendoset numri i regjistrimit dhe data e lëshimit të miratimit për prodhimin e armëve dhe municioneve dhe për riparimin e armëve; në kolonën “Procedura teknike”, vendoset procedura teknike e zbatuar për bërjen e armës përkohësisht të papërdorshme (çaktivizimi); në kolonën “Dokument i armës”, vendoset numri i regjistrimit, data e lëshimit dhe periudha e vlefshmërisë së dokumenteve të armës; në kolonën “Shënim”, vendoset çdo ndryshim thelbësor i të dhënave të vendosura më parë në regjistër.”

Neni 6

Pas nenit 40, shtohet një nen i ri 40-a i cili përmban tekstin e mëposhtëm:

“Neni 40-a

Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armëve të zjarrit të bëra përkohësisht të papërdorshme (të çaktivizuara) përbëhet nga kolonat e mëposhtme: numri rendor, numri i regjistrimit të certifikatës, data e certifikatës, personi fizik, arma, numri i vendimit për trashëgiminë dhe shënime (Formulari nr. 53-a).

Në formularin e regjistrimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni vendosen të dhënat e mëposhtme: në kolonën “Numri rendor”, vendoset numri rendor i hyrjes; në kolonën “Numri i regjistrimit të certifikatës”, vendoset numri i regjistrimit të certifikatës për posedimin e armës së lëshuar për armët e zjarrit të bëra përkohësisht të papërdorshme (të çaktivizuara); në kolonën “Data e certifikatës”, vendoset data e lëshimit të certifikatës për armët e zjarrit të bëra përkohësisht të papërdorshme (të çaktivizuara); në kolonën “Personi fizik”, vendoset emri, mbiemri, adresa e vendbanimit të përhershëm apo të zakonshëm dhe numri personal i identifikimit të personit fizik; në kolonën “Arma”, vendoset kategoria, lloji, marka, kalibri dhe numri i serisë së armës; në kolonën “Numri i vendimit për trashëgiminë”, vendoset numri dhe data e lëshimit të vendimit për trashëgiminë; dhe në kolonën “Shënim”, vendoset çdo ndryshim thelbësor në të dhënat e vendosura më parë në regjistër.

Neni 7

Formularët nr. 17-a, 17-b, 19-a, 45-a, 45-b dhe 53-a i bashkëngjiten shtojcës dhe bëhen pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Rregulloja hyn në fuqi në ditën e tetë pas botimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Stema

**REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

(Emri i njësisë organizative)

Numri _____

Data _____

Në përputhje me nenin 21 paragrafi 4 të ligjit “Për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 7/2005, 47/2006, 42/2007, 86/2008 dhe 72/2010), autoriteti kompetent lëshon këtë

CERTIFIKATË PËR POSEDIMIN E ARMËS
që zëvendëson autorizimin për posedimin e armës

Për _____ lindur më _____ (data)
(Emri dhe mbiemri)

në _____, shtetas i _____, numri
personal i identifikimit _____, me vendbanim të përhershëm ose të zakonshëm në
_____ në shtetin e _____

Për të **ZËVENDËSUAR** autorizimine personit për posedimin e armës me numër regjistrimi
_____ lëshuar nga _____ me një **CERTIFIKATË**
PËR POSEDIMIN E ARMËS kategoria _____, lloji
kalibri _____ mm, numri i serisë _____.

SHËNIM: Kjo certifikatë nuk e autorizon zotëruesin të përdorë armën.

Vula

PERSONI I AUTORIZUAR

Stema

**REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

(Emri i komisionit)

Numër _____

Data _____

Në përputhje me nenin 51-b paragrafi 2 të ligjit "Për armët" (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 7/2005, 47/2006, 42/2007, 86/2008 dhe 72/2010), autoriteti kompetent lëshon këtë

**CERTIFIKATË PËR POSEDIMIN E ARMËS TË BËRË
PËRKOHËSISHT E PAPËRDORSHME**

A) TË DHËNA PËR PERSONIN FIZIK (ZOTËRUESI I ARMËS)

(Emri dhe mbiemri)

Numri personal i identifikimit: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

(Shteti, bashkia, rruga dhe numri i shtëpisë)

B) TË DHËNA PËR PERSONIN JURIDIK (ZOTËRUESI I ARMËS)

(Emri i personit juridik)

(Selia e regjistruar e personit juridik)

Shoqëria _____

(Emrii shoqërisë)

pas kryerjes së procedurës teknike _____

(Përshkrimi i procedurës teknike)

KABËRË PËRKOHËSISHT TË PAPËRDORSHME ARMËN

e kategorisë _____ lloji _____

marka, _____, kalibri _____, numri i serisë _____

të renditur në dokumentin e mëposhtëm të lëshuar për armën _____

(Emërtimi i dokumentit të armës)

me numër _____, data e lëshimit _____

lloji i autorizimit _____.

Vula

PERSONI I AUTORIZUAR

Stema

**REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

(Autoriteti kompetent)

Numër _____

Data _____

Në përputhje me nenin 21 paragrafi 5 të ligjit "Për armët" (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 7/2005, 47/2006, 42/2007, 86/2008 dhe 72/2010), autoriteti kompetent lëshon këtë

**CERTIFIKATË PËR POSEDIMIN E ARMËS SË ZJARRIT TË
BËRË PËRKOHËSISHT E PAPËRDORSHME**

TË DHËNA PËR PERSONIN FIZIK (ZOTËRUESI I ARMËS SË ZJARRIT)

(Emri dhe mbiemri)

Numri personal i identifikimit: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

(Shteti, bashkia, rruga dhe numri i shtëpisë)

Vlefshmëria e vendimit nr. _____ duke filluar nga _____

_____ në _____.

Shoqëria _____

(Emrii shoqërisë)

pas kryerjes së procedurës teknike _____

(Përshkrimi i procedurës teknike)

KABËRË PËRKOHËSISHT TË PAPËRDORSHME ARMËN E ZJARRIT

e kategorisë _____ lloji _____

marka, _____, kalibri _____, numri i serisë _____

të renditur në dokumentin e mëposhtëm të lëshuar për armën _____

(Emërtimi i dokumentit të armës)

me numër _____, data e lëshimit _____

lloji i autorizimit _____.

SHËNIM: Kjo certifikatë nuk e autorizon zotëruesin të përdorë armën.

Vula

PERSONI I AUTORIZUAR

Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armëve me synim zëvendësimin e autorizimeve për posedimin e armëve

Numri	Numri i regjistrimit të certifikatës	Data e certifikatës	Personi fizik	Arma	Shënim
1	2	3	4	5	6

Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armës së bërë përkohësisht e papërdorshme

Numri	Personi fizik ose juridik	Arma	Shoqëria	Numri i regjistrimit dhe data e lëshimit të miratimit për prodhimin e armëve dhe municioneve, si dhe për riparimin e armëve	Procedura teknike	Dokumenti i armës	Shënim
1	2	3	4	5	6	7	8

Regjistri i certifikatave të lëshuara për posedimin e armës së zjarrit të bërë përkohësisht e papërdorshme

Numri	Numri i regjistrimit të certifikatës	Data e certifikatës	Personi fizik	Arma e zjarrit	Vlefshmëria e vendimit	Shënim
1	2	3	4	5	6	7

